



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr. 03. L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (LVL), nenit 9, pika 1.6 të Statutit të Komunës së Gjiçanit 01. nr. 16-126211 dt. 06.11.2014, me ndryshimet dhe plotësimet në Statutit, 01.nr.016-28448 të dt: 22.03.2018, duke e parë gjendjen e rëndë të banimit të familjes 5 anëtarsh Veliu nga Gjiçani dhe nevojën për strehimin e tyre dhe duke u bazuar në kërkesën 02.nr.016-34878/23 të datës: 06.04.2023 të kësaj familje, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

VENDIM

PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM TË PËRKOHSHËM TË BANESËS - PRONË
KOMUNALE

(Vazhdim)

Neni 1

Me këtë vendim i JEPET në shfrytëzim të përkohshëm prona komunale sipas njësisë 0-70403013-03532-0-214-0-17-0, Banesë 3 dhomëshe me sipërf. prej 80m², e cila gjindet në rr. "A.Tahiri", kati i III-të. Nr.1., Gjiçan, familjes 5 anëtarëshe të znj. [REDACTED] me gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale nga Gjiçani, për plotësimin e nevojës urgjente të strehimit të saj.

Neni 2

2.1. Kohëzgjatja e shfrytëzimit të pronës komunale sipas nenit 1 të këtij vendimi nga shfrytëzuesja, do jetë e përkohëshme nga data e skadimit të vendimit paraprak: 01.06.2023 deri më: 31.05.2024/1 vit, pa mundësi vazhdimi.

2.2. Pas skadimit të këtij afati shfrytëzuesja është e obliguar ta dorzojë banesën në gjendje të rregullt, sikur kur e ka pranuar.

Neni 3

Shfrytëzuesja, nuk mund t'ia kalojë të drejtat dhe obligimet që rrjedhin nga ky vendim në persona të tretë.

Neni 4

Shfrytëzuesja, është përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe kujdesin nga dëmtimet eventuale të objektit banesor dhe kryerjen e obligimeve ndaj shërbimeve të komunalisë (shpenzimeve të rrymës, ujit, mbeturinave, telefonis).

Neni 5

Për realizimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, kurse për zbatimin e tij kujdeset Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale dhe Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim.

Neni 6

Ky vendim është i plotfuqishëm me aktin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Kryetari i Komunës

Alban Hyseni



Shtojcë e Vendimit:

- **Letër përcjellëse nga DSHPIB**

Kopje:

- Drejtorisë për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim;
- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale dhe
- Arkivës së Komunës

Letër percjellëse:

Zonja [REDAKTUAR], Ju njoftojmë se pas skadimit të afatit të lartcekur në vendim, Ju jeni të obliguar ta lironi pronën komunale sipas njësisë 0-70403013-03532-0-214-0-17-0, Banesë 3 dhomëshe me sipërf. prej 80m², e cila gjindet në rr. "A.Tahiri", kati i III-të. Nr.1., Gjilan, duke e kthyer të njejtën në gjendjen e mëparshme, sepse në komunën tonë ka raste edhe më të rënda sociale që duhet trajtuar prandaj ju duhet të bëni një zgjidhje rreth sigurimit të strehimit për familjen tuaj.

Po ashtu si që është e cekur në nenin 4 të vendimit ju jeni përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe kujdesin nga dëmtimet eventuale të objektit banesor dhe kryerjen e obligimeve ndaj shërbimeve të komunalisë (shpenzimeve të rrymës, ujit, mbeturinave, telefonis) dhe me rastin e dorzim-pranimit të objektit banesor duhet të sillni dëshminë për obligimet e kryera në : 0 (zero), në të kundërtën nuk do të bëhet pranim-dorzimi i banesës nga Qiradhënësi, Komuna - DSHPIB-ja, por do të merren masa ligjore për mos zbatim të dizpozitave që dalin nga vendimi.

Ju falenderit për mirëkuptim!

DREJTORI
Mentor Mhoveci

